




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION



Referencë: **IPK/20052022/DI**

Datë: **20.05.2022**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

### RAPORT I INSPEKTIMIT

<b>Titulli - objekti</b>	- Vlerësimi i ligjshmërisë lidhur me sistemimin e zyrtarëve policor nga Stacioni Policor i Skenderajt
<b>Referenca</b>	- 03/2022
<b>Data e inicimit</b>	- 12.04.2022
<b>Data e raportimit</b>	- 20.05.2022
<b>Arsyet e inicimit</b>	- Me propozimin e Udhëheqësit të Departamentit për Menaxhimin e Ankesave, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj me datën 12.04.2022 ka kërkuar realizimin e inspektimit të jashtëzakonshëm në Polici për të vlerësuar ligjshmërinë e sistemimit të zyrtarëve policor, me theks të veçantë të transferimeve të përkohshme nga Stacioni Policor - Skenderaj. Propozimi ka ardhur si rezultat i pranimit të ankesave nga disa zyrtarë policor nga ky Stacion, lidhur me shqetësimet e tyre mbi mënyrën e sistemimit (transferimit) të tyre jashtë Stacionit.
<b>Objektivi</b>	- Vlerësimi i ligjshmërisë në lëvizjen e burimeve brenda strukturës; - Vlerësimi i respektimit të parimeve të trajtimit të barabartë dhe të mos diskriminimit; - Vlerësimi i respektimit të kërkesave dhe kushteve të vendeve të punës me rastin e lëvizjes (sistemimit) të zyrtarëve policor.
<b>Metodologjia</b>	- Intervistë (takime) me gjashtë (6) zyrtarë dhe bartës funksionesh: (a) Shefi i Sektorit Rajonal për Resurse - Mitrovicë Jugu, (b) Komandanti i Stacionit Policor - Skenderaj, (c) Zyrtarë policor parashtrues të ankesave. - Këqyrje dhe verifikim: 84 dosje të personelit lidhur me sistemimet (transferimet) e zyrtarëve policor jashtë stacionit, - Marrje dokumentesh për nevoja të raportimit.
<b>Subjekti</b>	- Departamenti i Kufirit, - Drejtoria Rajonale Policore - Mitrovicë Jugu, - Stacioni Policor - Skenderaj.
<b>Afatet</b>	- Fillimi - 20.04.2022; - Përfundimi - 22.04.2022; - Periudha e mbulimit - tre (3) vitet e fundit.

<b>Kriteret vlerësuese (standardet)</b>	- Ligji nr. 04/L- 076 për Policinë, - Udhëzimi Administrativ nr.01/2021 mbi marrëdhënien e punës në PK, - PSO - Procedura e sistemimit të punonjësve në Policinë e Kosovës.
<b>Ekipi realizues</b>	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Ekipit të Inspektimit
<b>Mbështetur nga</b>	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i PK-së
<b>Datë</b>	- 20.05.2022





<p><b>Gjetjet kryesore:</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L- 076 për Policinë, saktësisht me nenin 44 të këtij Ligji, marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt të veçantë nënligjor. Me qëllim të rregullimit të marrëdhënies së punës, Policia e Kosovës (PK) ka tani në fuqi Udhëzimin Administrativ nr. 01/20211 mbi marrëdhënien e punës në PK, i cili deri në versionin e tanishëm, ndër vite është plotësuar - ndryshuar vazhdimisht. Ky Udhëzim rregullon marrëdhënien e punës për personelin policor, duke përfshirë themelimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet, kriteret për punësim, procedurat e rekrutimit - seleksionimit, sistemimin - avancimin e punonjësve në vendet e punës, orarin e punës, pagat e kompensimet, si dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Me qëllim të shpërndarjes së duhur të burimeve njerëzore dhe në përputhje me politikat e menaxhimit, Policia ka hartuar po ashtu edhe Procedurën Standarde të Operimit (PSO) që rregullon procedurën e sistemimit të punonjësve policor, me anë të së cilës sqarohen (specifikohen) hapat dhe veprimet lidhur me transferimin e punonjësve brenda strukturës, duke krijuar mundësi të barabarta dhe proces transparent për gjithë të punësuarit.</li> <li>2. Meqenëse Policia është organizatë e madhe e komplekse, krahas sfidave të shumta, ajo shpesh ballafaqohet me mungesë të fuqisë punëtore. Për shkak të nevojave operacionale dhe plotësimit të strukturës organizative, kjo organizatë ka paraparë lëvizje të personelit duke aplikuar transferimin nga një njësi, stacion, drejtori apo departament në njësi, stacion, drejtori, a departament tjetër<sup>1</sup>. Për shkak të ndikimit të një sërë faktorësh në vitet e fundit, Departamenti për Kufi dhe Drejtoria për Sigurimin e Objekteve dhe Personaliteteve (DSOP) janë ballafaquar vazhdimisht me mungesë burimesh, duke u rrezikuar funksionaliteti normal i tyre. Për të plotësuar nevojat operacionale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (DPP) ka vë në funksion plotësimin e mungesave në personel përmes sistemimit apo transferimit të tij nga drejtoritë rajonale (stacionet policore të Divizionit për Siguri Publike). Drejtoria Rajonale - Mitrovicë Jugu vazhdimisht ka mbështetur me burime njerëzore, Departamentin për Kufi dhe DSOP-në. Zyrtarë policor nga stacionet policore të DRP - Mitrovicë Jugu (Mitrovicë Jugu, Vushtri dhe Skenderaj) janë transferuar në periudha nga tre deri në gjashtë muaj në Stacionet Policore për Mbikëqyrje të Kufirit (SPMK) në kuadër të Drejtorisë Rajonale Policore Kufitare - Veriu (DRPK). Nga fundi i muajit mars të këtij viti, DPP ka vendosur që sistemimet në kohë të caktuar në Departamentin për Kufi të zëvendësohen me sisteme të përhershme në kohë të pacaktuar. Të pakënaqur me këto vendime, disa zyrtarë policor në Skenderaj janë ankuar, duke ngritur shqetësimet e tyre lidhur me shkeljen e të drejtave, përfshirë trajtimin jo të barabartë gjatë proceseve të transferimeve të përkohshme.</li> <li>3. Sipas praktikave të viteve të fundit, për plotësimin e nevojave policore me personel, DPP-ja ka kërkuar nga DRP - Mitrovicë Jugu që të caktojë personel për ta transferuar përkohësisht në Departamentin për Kufi. DRP - Mitrovicë Jugu u është përgjigjur kërkesave të DPP-së dhe ka vënë në dispozicion personel duke i transferuar me këtë rast, zyrtarët policor me kohë të caktuar, në faza apo cikle nga çdo tre muaj. Sipas kësaj praktike, për çdo fazë tre mujore DRP-ja në fjalë ka kërkuar nga stacionet policore (Mitrovicë Jugu, Vushtri e Skenderaj) që të nominojnë zyrtarët policor për transferime të përkohshme jashtë Drejtorisë. Gjatë viteve të fundit,</li> </ol>
---------------------------------	---

<sup>1</sup> Udhëzimi Administrativ nr.01/2021 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.



	<p>Stacioni Policor në Skenderaj vazhdimisht ka asistuar Policinë Kufitare me zyrtarë policor përmes transferimeve për kohë të caktuar, me shërbim në kuadër të SPMK-ve (DRPK- Veriu). Pas përfundimit të ciklit të fundit, me kërkesë të drejtuesve rajonal, Stacioni Policor- Skenderaj ka dërguar listën e re me emrat e zyrtarëve policor për të zëvendësuar ata të grupit të fundit të të transferuarve. Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë lidhur me lëvizjen e burimeve njerëzore, IPK-ja ka inspektuar procedurën e transferimit të zyrtarëve policor nga Stacioni Policor - Skenderaj. Lidhur me të gjitha këto sisteme të përkohshme, DPP ka lëshuar vendime për secilin zyrtar policor, kopje të të cilave i janë siguruar IPK-së. Autoriteti vendimmarrës policor pas periudhës gjashtëmuajore ka vendosur që nëntë (9) zyrtarët policore të Skenderajt, të transferuar përkohësisht më parë nëpër SPMK (DRPK- Veriu), të sistemohen për kohë të pacaktuar, aty ku edhe kanë shërbyer gjatë gjashtë muajve të fundit<sup>2</sup>. Bazuar në nenin 33 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi marrëdhënien e punës në PK, Policia për shkak të nevojave operative mund të sistemojë zyrtarët policor për kohë të caktuar apo të pacaktuar, pa pëlqimin e tyre, prej një vendi në një vend tjetër pune. DRP - Mitrovicë Jugu dhe autoriteti vendimmarrës, me vendimet për sistemin të zyrtarëve policorë, fillimisht me kohë të caktuar në dy cikle nga tre (3) muaj radhazi, si dhe së fundmi në kohë të pacaktuar, kanë reflektuar sikur nuk kanë aplikuar standardet për trajtim të barabartë të punonjësve.</p> <p>4. Me PSO-në e cekur më lartë, Policia në parim ka vendosur që me rastin e sistemeve dhe transferimeve të zyrtarëve policor prej një vendi në një vend tjetër të punës, të aplikohet shpërndarje e rregullt e personelit në përputhje me politikat e menaxhimit dhe dispozitat e Udhëzimit në fjalë. Mbi bazën e këtij parimi, Policia ka për qëllim krijimin e një procesi të drejtë gjatë transferimeve në kuadër të strukturës, duke krijuar mundësi të barabarta dhe proces transparent. Për të vlerësuar respektimin e këtij parimi gjatë përzgjedhjes së zyrtarëve policor për t'u sistemuar për kohë të caktuar, IPK-ja ka kryer verifikime për 84 zyrtarë policor të Stacionit Policor - Skenderaj. Në bazë të të dhënave të siguruara nga dosjet e Zyrës së Resurseve të këtij Stacioni, për 10 vitet fundit janë realizuar rreth 300 transfere për kohë të caktuar për 84 zyrtarë. Nga 84 zyrtarë policor sa ka Stacioni - katër (4) prej tyre (4.8%) rezultojnë të mos jenë përfshirë në proceset e transfereve, tetë (8) sish (9.5%) janë përfshirë nga një (1) herë, gjashtë (6) sish (7.1%) nga dy (2) herë, 12 sish (14.3%) nga tre (3) herë, 29 sish (34.3%) nga katër (4) herë, 18 sish (21.4%) nga pesë (5) herë, gjashtë (6) sish (7.1%) nga gjashtë (6) herë, kurse një (1) zyrtar policor (1.2%) është përfshirë shtatë (7) herë. Një pjesë e zyrtarëve janë përfshirë më shpesh në transfere, në raport me disa të tjerë që janë atakuar më rrallë apo fare nga vendimet për transfere. Si pasojë janë shfaqur pakënaqësi tek disa zyrtarë, të cilët edhe kanë parashtruar ankesa. Drejtuesit policor kanë arsyetuar një vendimmarrje të tillë, duke treguar se stacionet kanë në kuadër të tyre edhe personel me probleme fizike dhe shëndetësore, të cilët nuk mund të përfshihen në ciklet e transfereve. Nga deklaratimet e drejtuesve, jo gjithëherë situatat lejojnë që të aplikohet gjithëpërfshirja nga radhët e personelit në ciklet e transfereve bazuar në atë se disa vende pune që kërkohet të plotësohen me personel, janë specifike, ku edhe Policia duhet t'i kushtojë rëndësi veç tjerash dhe integritetit të zyrtarëve, kriterit gjinor dhe gjendjes fizike dhe shëndetësore të personelit të stacioneve.</p>
--	--

<sup>2</sup> Inicialet e zyrtarëve policor të transferuar: H.B (PK-0476), S.S (PK-3449), I.J (PK-5392), F.P (PK-6221), A.G (PK-8662). L.S (PK-8785), A.A (PK-10273), B.S (PK-10465), E.B (PK-10163).



	<p>5. Nga praktika është e njohur se detyrat në kuadër të shërbimeve policore kufitare në masë të konsiderueshme dallojnë nga ato në kuadër të sigurisë publike. Zyrtarët policor për të shërbyer në kuadër të strukturës kufitare, krahas trajnimit bazik për zyrtarët policor, nevojitet që të jenë të pajisur edhe me njohuri nga kurse trajnuese nga disa fusha që konsiderohen si të domosdoshme për kryerjen e detyrave për kontroll - mbikëqyrje kufitare. Bazuar në Katalogun e trajnimeve të përgatitur nga Divizioni i Trajnimit të Policisë së Kosovës, si një përmbledhje nevojash të dalur nga analiza për trajnime, pasqyrohet se Policia ofron trajnime të veçanta për kontroll dhe mbikëqyrje të kufirit, si dhe përdorimin e armëve të gjata MP-5 dhe AK-47. Lidhur me këtë, për të vlerësuar se a i kanë përmbushur zyrtarët policor të transferuar, kërkesat për vendet e punës, në Zyrën e Resurseve të Stacionit Policor - Skenderaj është verifikuar nëse zyrtarët e sistemuar për kohë të pacaktuar në Departamentin për Kufi, kanë vijuar trajnimet e nevojshme. Nga të dhënat e siguruara nga inspektimi rezulton se zyrtarët policor nuk kanë vijuar trajnime në fushat specifike. IPK është interesuar të njihet me faktin nëse trajnimet e tilla janë kusht që duhet përmbushur para se të realizohen transferet e tilla. IPK është njoftuar nga drejtuesit e Departamentit për Kufi se për t'u caktuar në kuadër të strukturës kufitare, nuk nevojitet ndonjë kurs apo trajnim i veçantë, veç kursit bazik për zyrtar policor. Sipas tyre, pas transferimit të zyrtarëve policor në polici kufitare, fillon procedura e trajnimit sipas programit bazik të policisë kufitare.</p>
<p><b>Vlerësimi i përgjithshëm</b></p>	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✦ Varësisht nga nevojat operative e organizative, Policia mund të sistemojë punonjësit prej një vendi, në një vend tjetër të punës edhe pa pëlqimin e tyre. Lëvizja e burimeve vlerësohet e arsyeshme dhe e nevojshme, duke pasur parasysh nevojat operative si rezultat i situatës së krijuar të sigurisë.</li> <li>✦ Gjatë sistemimit për kohë të caktuar të zyrtarëve policor nga Stacioni Policor - Skenderaj nuk është ndjekur sa duhet praktika gjithëpërfshirëse për zyrtarë policor në ciklet e transfereve jashtë regjioni, që është ndikuar nga natyra e kërkesave specifike për vendet e punës.</li> <li>✦ Zyrtarët policor të sistemuar nga Stacioni Policor në Skenderaj, në kuadër të SPMK-ve të Departamentit për Kufi, nuk kanë vijuar trajnime specifike për vendet e punës ku janë angazhuar tanimë, por që sipas drejtuesve të strukturës kufitare, ata së shpejti do t'i nënshtrohen trajnimeve përkatëse.</li> </ul>
<p><b>Rekomandimet</b></p>	<p>Bazuar në gjetjet, vlerësimin e përgjithshëm të inspektimit dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve policore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. IPK u rekomandon drejtuesve të Drejtorisë Rajonale Policore - Mitrovicë Jugu dhe Stacionit Policor në Skenderaj që para sistemimit (transferimit) të personelit policor jashtë regjionit, të kujdesen që nominimi i tyre të bazohet në parimin e gjithëpërfshirjes në ciklet e transfereve, duke pasur parasysh edhe kërkesat specifike për vendet e punës që duhet plotësuar, gjendjen fizike dhe shëndetësore të personelit, aspektin gjinor, etj.</li> </ol>

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorisë Rajonale Policore - Mitrovicë Jugu dhe Stacionit Policor në Skenderaj që para sistemimit (transferimit) të personelit policor jashtë regjionit, të kujdesen që nominimi i tyre të bazohet në parimin e gjithëpërfshirjes në ciklet e transfereve, duke pasur parasysh edhe kërkesat specifike për vendet e punës që duhet plotësuar, gjendjen fizike dhe shëndetësore të personelit, aspektin gjinor, etj.</i>	<i>-/-</i>	<i>Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Jugu do të jetë e kujdesshme si çdo herë që në bashkëpunim me stacionet policore për sistemin (transferim) të personelit policor çdo herë të bazohemi në nevojat operative të organizatës dhe në parimin e gjithëpërfshirjes, gjithmonë duke pasur parasysh specifikat e pozitës për ku dhe transferohen, duke marrë për bazë moshën e personelit, aspektin gjinor, gjendjen shëndetësore dhe fizike të tyre, integritetin, etj.</i>	<i>Në vazhdimësi</i>